



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 35, datë 24.02.2020

PËR

**KRYERJEN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS  
TË MAGJISTRATËVE, KANDIDATË PËR T’U KOMANDUAR SI INSPEKTORË  
PRANË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenin 149/a, pika 1, gërma “e”, të Kushtetutës, në nenet 209, 211/ pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53 dhe 55, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” miratuar me vendimin nr. 171, datë 27.09.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale:

**VENDOSI:**

1. Të kryejë verifikimin e pasurisë dhe figurës të magjistratëve, kandidatë për t’u komanduar si Inspektorë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Të hartojë raporte të veçanta me rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës për çdo magjistrat, kandidat për t’u komanduar si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore për kryerjen e këtij procesi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KRYETAR**

**GENT IBRAHIMI**

